

Në bazë të nenit 19 alinea 2 të Ligjit për menaxhim me mbeturina (Gayeta zyrtare e RMV, nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 143/08, 124/10, 51/11, 123/12, 147/13, 163/13, 51/15, 146/15, 156/15, 192/15, 39/16, 63/16, 31/20 dhe 216/2021), me propozim të Kryetari i komunës së Bërvenicës, Këshilli i komunës së Bërvenicës në mbledhjen e mbajtur me 30.01.2023 solli:

**PROGRAMË
PËR
MENAXHIMIN ME MBETURINA
PËR VITIN 2023**



Bërvenicë, Janar 2023

Përmbajtja:

1. Vlersimi i llojit dhe sasisë të mbeturinave i cili krijohet në komunën e Bërvenicës në nivel vjetor.....3
2. Mënyra e përmbushjes së obligimeve të subjekteve juridike dhe fizike të cilët menaxhojnë me mbeturina.....4
3. Masat dhe aktivitetet për vogëlimin e sasisë të mbeturinave të krijuara, selektimin e mbeturinave si dhe ndarjen e materjaleve të rrezikshme nga mbeturinat.....4



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërvenicës për vitin 2023

4. Mënyra e edukimit dhe ngritja e ndërgjegjes tek qytetarët në lidhje me menaxhimin me mbeturina.....4
5. Realizimi i detyrimeve për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave biodegraduese i cili ndahet në deponitë.....6
6. Mënyra e punës të objekteve dhe instalimeve për përpunimin dhe mënjanimin e mbeturinave.....7
7. Mënyra e funksionimit të rrijetit të integruar për Përpunimin dhe eliminimin e mbeturinave.....7
8. Mbyqyrja dhe sistemi informativ në lëmine e menaxhimit me mbeturina.....7
9. Masa të tjera të rëndësishme për menaxhimin me mbeturina.....7
10. Masa dhe aktivitete programore për vitin 2022.....8

Komuna e Bërvenicës në vitin 2019 për nevojat e përpilimit të studimit të fizibilitetit si dhe përpilimit të Planit për menaxhim me mbeturinave të Rajonit të Pollogut bëri vlersimin e përmbajtjes të mbeturinave komunale sipas llojit dhe sasisë. Sasia e përbërësve kryesor të mbetjeve komunale janë të paraqitura në Tabelën 1.

Tabela 1: Përbërja e mbetjeve komunale dhe sasia sipas llojit në vitin 2019

Lloji I mbeturinave	Sasia në t/vit	Përfshirja në %
Mbeturina organike	380,2	26,2%
Dru	39,96	2,7%
Lëter dhe karton	170,68	11,6%
Plastikë	36,97	2,5%
Staklo	51,8	3,5%
Metali	38,48	2,6%
Tekstil	42,92	2,9%
Ambalaxha plastike	106,48	7,2%
Meturina të rrezikshme	2,96	0,2%
Komostime	32,56	2,2%
Produkte komplekse	4,44	0,3%



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërvenicës për vitin 2023

Mbeturina Inerte	53,28	3,6%
Kategori tjera	53,28	3,6%
Frakcione të imëta	457,32	30,9%
Gjithsej	1479	100%

Përqindja e përbërjes të meturinave komunale dhe sasia sipas llojit për vitin 2023 është paraqitur në Tabelën

Tabela 2: Përqindja e përbërjes e meturinave komunale dhe sasia sipas tipit për vitin 2023

Lloji i mbeturinave	Sasia t/vit	Përfshirja me %
Mbetjet e biodegradueshme (mbeturinat e kopshtit, kuzhina)	898,5	41.5 %
Letër	95,7	4.3 %
Karton	123,4	5.7 %
Qelq	95,7	4.3 %
Metale që përmbajnë hekur	32,47	1.5 %
Metale që nuk përmbajnë hekur	23,81	1.1 %
LDPE plastik	138,56	6.4 %
Paketime plastike	32,47	1.5 %
PET paketime	90,92	4.2 %
Plastikë tjetër	56,29	2.6 %
Tekstil	69,28	3.2 %
Lëkurë	19,48	0.9 %
Pelena	23,81	1.1 %
Mbeturinat nga ndërtimet dhe prishjet e ndërtesave	116,91	5.4 %
Dru	38,97	1.8 %
Mbeturina elektrike dhe elektronike	13,42	0.62 %
Mbeturina të rrezikshme	4,97	0.23 %
Paketim tetrapak	32,47	1.5 %
Frakcione (<10 mm dhe <20 mm)	265,21	12.25 %
Gjithsej	2165	100 %

2. Mënyra e përmbushjes të obligimeve të subjekteve juridike dhe fizike të cilat menaxhojnë me mbeturina

Në bazë të Ligjit për menaxhim me mbeturina (Gazeta zyrtare e RMV, nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 143/08, 124/10, 51/11, 123/12, 147/13, 163/13, 51/15, 146/15, 156/15, 192/15, 39/16, 63/16, 31/20 dhe 216/2021), subjektet juridike dhe fizike të cilët gjatë aktivitetit të tyre brenda vitit kalendarik krijojnë më shumë se 200 kilogram mbetje të rrezikshme ose më shumë se 150 tonelata mbetje jo të rrezikshme janë të obliguar të pëpilojnë dhe ta realizojnë Programën për menaxhim me mbeturina, në përputhje me nenin 19 të Ligjit të lartpërmendur.

3. Masat dhe aktivitetet për zvoglimin e sasisë të mbeturinave të krijuara, selektimin e mbeturinave si dhe ndarjen e materjaleve të rrezikshme nga mbeturinat

Kjo Programë për menaxhimin me mbeturina për vitin 2023 parashikon vendosjen e sistemit për selektim të mbeturinave nëpërmjet:

- Realizimi i një fushate publike për nevojat e riciklimit
- Zgjerimi i grumbullimit selektiv të letërës, ambalazheve PET, qelqit, baterive dhe mbetjeve të pajisjeve elektronike dhe elektrike.



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërvenicës për vitin 2023

-

Realizimi i një fushate publike për nevojat e riciklimit me këtë program është planifikuar të realizohet përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- Përgatitja e një plani pune për ngritjen e vetëdijes publike;
- Përcaktimi i grupeve të synuara;
- Takime pune dhe ligjërata në nivele të ndryshme.

Zgjerimi i grumbullimit selektiv të letrës, ambalazheve PET, xhamit, baterive dhe mbetjeve të pajisjeve elektronike dhe elektrike është planifikuar të realizohet përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- Sigurimi i konstrukcionit financiar;
- Përcaktimi dhe rregullimi i lokacioneve për qendrat e grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve të ricikluara;
- Përcaktimi i lokacioneve për shuj ekologjik për mbetjet e përzgjedhura;
- Prokurimi i kontejnerëve për seleksionimin e mbeturinave;
- Procedura për marrjen e lejes për ruajtje dhe trajtim;
- Selektim i vazhdueshme i mbetjeve në shkolla dhe kopshte.

Për sa i përket ndarjes së përbërësve të mbetjeve të rrezikshme, përveç baterive dhe mbetjeve nga pajisjet elektronike dhe elektrike për të cilat është planifikuar të vendoset grumbullimi i centralizuar, personat juridikë dhe individët që prodhojnë mbetje të rrezikshme do të detyrohen nëpërmjet lejeve të integruara ekologjike dhe raporteve për mbrojtjen e mjedisit të lidhin marrëveshje me persona juridikë të autorizuar për grumbullimin e mbeturinave të rrezikshme.

4. Mënyrat për edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për menaxhimin me mbeturina

Në përgjithësi, niveli i vetëdijes për ambientin jetësorë në Komunën e Bërvenicës duhet të ngrihet përmes:

- Edukimi për mjedisin jetësorë në shkolla;
- Edukim shtesë ose shpërndarje e informacionit për mjedisin jetësorë;.

Fushata e ndërgjegjësit publik duhet të mbështesë qëllimet e mëposhtme:

- Zgjerimi (sipas zonave dhe llojeve) i grumbullimit selektiv të llojeve të mbetjeve të riciklueshme;
- Përmirësimi i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve mjekësore dhe të rrezikshme;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve organike nga bujqësia;
- Promovimi dhe mbështetja e biokompostimit;
- Promovimi i parimeve "nga mbeturinat në energji";
- Zbatimi konsekuent i dispozitave të Ligjit për Menaxhment me mbeturina.

Është thelbësore të përfshihen grupet kryesore të synuara në përgatitjen dhe zbatimin e fushatës së ndërgjegjësit publik. Për Komunën e Bërvenicës, palët potenciale të interesit dhe grupet e synuara janë:

- Publiku i gjerë - amvisëritë;
- Autoritetet lokale;
- Institucionet arsimore parashkollore dhe shkollore;
- Sektori tregtar dhe industrial;
- shërbimeve komunale dhe menaxhimit të mbetjeve;
- Ambulancat dhe Farmacitë;
- Sektori informal;
- OJQ-të dhe OSHC-të; dhe
- Media dhe kanale të tjera komunikimi.



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërvenicës për vitin 2023

Rekomandohet që fushata e ndërgjegjësimit të publikut të fokusohet në tre grupe thelbësore çështjesh:

- Stop hedhja e paligjshme
- Rritja e mbulimit të grumbullimit të mbeturinave komunale (përfshirë gatishmërinë për të paguar për shërbim më të mirë);
- Kalimi në depozitimin e kontrolluar të mbetjeve (deponi rajonale);
- Pastrimi i deponive ilegale ekzistuese; dhe
- Rikuperimi i deponive ilegale.

Përmirësimi i parandalimit, ripërdorimit, riciklimit (p.sh. riciklimit) dhe pagesa

- Blerje inteligjent;
- Mbledhja selektive;
- Kompostimi;
- Transparenca e tarifimit, dmth. kostot e shërbimit.

Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme

- Grumbullimi selektiv i mbetjeve industriale;
- Grumbullimi selektiv i mbetjeve mjekësore;
- Menaxhimi selektiv dhe i duhur i mbetjeve elektrike dhe elektronike, baterive dhe akumulatorëve, gomave dhe mbetjeve të ngjashme;
- Menaxhimi i duhur i mbetjeve me origjinë shtazore.

Parimet e mëposhtme mund të rekomandohen për zhvillimin e një fushate ndërgjegjësimi publik:

- Qasja duhet të jetë proaktive dhe pozitive. Qytetarët nuk duhet të lihen të interpretojnë vetë ndryshimet, por duhet të kenë informacion në kohë për efektet dhe përfitimet pozitive;
- Ndryshimet e politikave dhe ndryshimet strukturore në fushën e menaxhimit të mbetjeve në nivel kombëtar dhe lokal nuk mund të zbatohen pa mbështetjen e publikut dhe pjesëmarrjen e tij aktive;
- Duhet të përdoren të dyja qasjet nga poshtë-lart dhe nga lart-poshtë;
- Fushata nuk duhet vetëm të shpërndajë informacione të caktuara, por edhe të krijojë mundësi për reagim publik, të cilat më pas do të merren parasysh;
- Është e rëndësishme jo vetëm t'u kërkohej grupeve të synuara të ndryshojnë qëndrimin dhe sjelljen e tyre, por edhe të shpjegojnë pse kërkohej dhe të tregojnë se si ta bëjnë këtë;
- Sigurohimi që grupeve të synuara u jepen mundësi për të ndryshuar sjelljen e tyre. Për shembull, komunikimi për mbledhje selektive shkon paralelisht me mundësitë e mbledhjes selektive;
- Mesazhi duhet të përsëritet dhe të përforcohet.

Programi për vitin 2023, ashtu si në vitet në vijim, parashikon informimin dhe edukimin e popullatës për vlerën e mbetjeve dhe rreziqet që vijnë prej tyre dhe lidhjen e tyre me burimet natyrore. Për këto arsye, ky Plani parashikon përdorimin e formave të ndryshme për edukimin dhe informimin e grupeve të caktuara të synuara, në pjesën e:

- Përzgjedhja e mbeturinave komunale, përmes fushatave publike dhe informimi i popullatës me broshura dhe fletë informative për grumbullimin selektiv të llojeve të mbeturinave të riciklueshme dhe rolin e tyre në sigurimin e lëndëve të para dytësore dhe vendndodhjet dhe mënyrën e seleksionimit;



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërvenicës për vitin 2023

- Organizimi i një fushate publike për edukimin e popullatës për përfitimet dhe mundësitë që ofron biokompostimi;
- Edukimi për parandalim në shkolla duke organizuar aktivitete;
- Organizimi i grumbullimit të ambalazheve PET dhe letrës së vjetër;
- Mbledhja e organizuar e baterive dhe mbetjeve elektronike dhe elektrike në shkolla dhe kopshte;
- Aksionet e donatorëve për grumbullimin e rrobave dhe sendeve të vogla. Artikujt e mbledhur mund të dhurohen në vend që të hidhen në një vendgrumbullim dhe në këtë mënyrë të rëndohen në mënyrë shtesë.

Fushata publike do të realizohet duke organizuar tribuna, materiale shtypi (broshura, fletëpalosje, etj.) dhe përmes mediave.

5. Realizimi i detyrimeve për reduktimin e sasisë së mbetjeve të biodegradueshme që hidhen në deponitë e egra.

Për të reduktuar sasinë e mbetjeve të biodegradueshme të depozituara në deponitë, ky program për menaxhim me mbeturinave parasheh të nisë procesin e biokompostimit të centralizuar. Komuna do të detyrohet të gjejë një vend, ky model i centralizuar i kompostimit do të mbulojë mbetjet e biodegradueshme të grumbulluara nga zonat publike dhe një pjesë të vogël të amvisërive. Në vitin 2023 është planifikuar vazhdimi i procesit duke analizuar modelet qendrore të kompostimit. Komposti i prodhuar do të përdoret nga NKP Vardar gjatë mirëmbajtjes së gjelbërimit nëpër vendbanime.

6. Mënyra e funksionimit të objekteve dhe instalimeve për përpunimin dhe depozitimin e mbetjeve

Komunë e Bërvenicës si organ nuk posedon objekte dhe instalime për përpunimin dhe depozitimin e mbetjeve komunale, mbeturinat komunale aktualisht mbledhen nga Konsesioneri EKO LIVING i cili bën mbledhjen, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale. Konsesioneri ka deponi të veten dhe posedon dokumentacion përkatës të lëshuar nga Ministrija e mjedisit jetësorë dhe planifikimit hapsinorë për mbledhje transport dhe përpunim të mbeturinave.

Komunës së Bërvenicës është anëtare e Ndërmarrjes komunale Regjionale Rusino e formuar në kuadër të rajonit të Pollogut e cila bën sistemin rajonal të menaxhimit të mbeturinave për rajonin të Pollogut dhe menaxhimin me deponinë rajonale Rusino Gostivarë.

Lidhur me deponinë për material inert, dhe dhe mbeturina ndërtimore, me vendim të Këshillit të Komunës së Bërvenicës janë përcaktuar dy lokacione të përkohshme, përkatësisht Muratski Dol në vendbanimin Çelopek dhe Leska në fshatin Tenovë deri sa të ndërtohet një deponi për materjalin inert ku do të riciklohet I njejtë dhe do të përdoret materjali I gryer për tamponimin e rrugëve.

7. Mënyra e funksionimit të rrjetit të integruar të përpunimit dhe depozitimit të mbetjeve

Menaxhimi i integruar i mbetjeve përfshin monitorimin e gjenerimit të mbetjeve, minimizimin e depozitimit, grumbullimit, transportit, trajtimit dhe asgjësimit në vend, duke rezultuar në një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve me mbulim të mirë dhe krijimin e objekteve të mjaftueshme adekuate për të ofruar shërbime të grumbullimit, transportit dhe asgjësimit. për ndërtimin dhe vënien në punë të deponisë rajonale.

Të gjithë personat juridikë dhe fizikë që prodhojnë mbeturina, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e mbeturinave janë të obliguar që të lidhin marrëveshje për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave me grumbulluesit e autorizuar të mbeturinave.

8. Realizimi i sistemit të monitorimit dhe informacionit në fushën e menaxhimit të mbetjeve

Monitorimi i gjendjes së mbeturinave në Komunën e Bërvenicës do të realizohet përmes krijimit të bazës së të dhënave përkatëse për gjendjen e mbeturinave në komunë e cila duhet të themelohet nga



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërvenicës për vitin 2023

komuna. Monitorimi për vitin 2023 do të bëhet me plotësimin e formularëve për identifikimin dhe transportin e mbetjeve si dhe me përgatitjen e raporteve vjetore për menaxhimin e mbetjeve. Këto janë të detyrueshme për kompaninë që do të menaxhojë mbetjet dhe për kompanitë më të mëdha, pra kompani që prodhojnë sasi më të mëdha mbetjesh. Administrata komunale nëpërmjet këtyre instrumenteve do të mund të ketë në çdo kohë një pasqyrë të situatës në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Natyrisht, kjo praktikë nuk ekziston ende plotësisht dhe për këtë arsye duhet futur sa më shpejt, pra në vitin 2023, që sistemi i monitorimit dhe informimit të mbetjeve të fillojë të funksionojë në kuptimin e vërtetë.

9. Masa të tjera në lidhje me menaxhimin e mbetjeve

Programi parashikon edhe mbylljen e deponive ilegale të egra në territorin e komuns së Bërvenicës dhe rehabilitimin e tyre.

Me qëllim të zvogëlimit të numrit të deponive ilegale që krijohen në territorin e komunës së Bërvenicës, është paraparë që të rritet hapësira për grumbullimin e mbeturinave komunale, me vendosjen e koshave të mbeturinave dhe transportin e rregullt të tyre. Aktualisht në teritorin e komunës së Bërvenicës në sipërfaqet publike ka të vendosura mbi 50 kosha për mbeturina si dhe 8 kontejner për grumbullimin e qelqit.

Planifikohet të vendosen edhe kosha për lloje të tjera të mbeturinave siç janë kosha për bateritë dhe mbeturinat elektronike, për vajin e përdorur nga amvisritë e automekanikët etj. Komuna e Bërvenicës disponon me automjetet për grumbullimin e mbeturinave donacion nga ambasada e Japonisë, si dhe është duke rrjedhur procedura për blerjen e 19 kontejnerëve me kapacitet 1.1 m³, të cilët do të përdoren për grumbullimin e shisheve plastike dhe kartonit dhe do të vendosen në të gjitha zonat e banuara në komunën. Kjo masë do të ndihmojë shumë në menaxhimin e suksesshëm të mbeturinave dhe gjithashtu për një mjedis më të pastër.

Komuna e Bërvenicës në vitin 2022 ka lidhur marrëveshje me kompaninë e licencuar për grumbullimin e mbeturinave nga bateritë dhe mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike, SHPK Nula Otpad nga Shkupi.

10. Masa dhe aktivitete programore për vitin 2023

Sfera 1: Lidhja me një sistem rajonal për grumbullimin, transportimin dhe asgjësimin e mbetjeve dhe mbylljen dhe riparimin e deponive ekzistuese.

Detyrat	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Buxheti (denarë)	Burimet e financimit
Pjesëmarrja në aktivitetet për realizimin e qasjes rajonale për menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Pollogut	Varsisht nga kërkesa e Rajonit Planorë të Pollogut	Komuna e Bërvenicës në bashkëpunim me komunat e Pollogut	2023 në vazhdimsi	Plani regjional për menaxhimin me mbeturina	Buxheti I RMV, IPA Fond, Partneritet publiko-privat, Buxheti komunës

Sfera 2: Intervenimi në sistemin e mbledhjes së mbeturinave

Detyrat	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Buxheti (denarë)	Burimet e financimit
---------	-------------	-------------------------	-------------	------------------	----------------------



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërvenicës për vitin 2023

Ndrimi dhe riparimi i kosheve për mbeturina	-Ndrimi i kosheve të vjetra me të rri. -Riparimi i kosheve	Komuna e Bërvenicës NKP Vardar	2023 në vazhdimsi		Komuna e Bërvenicës Donacione
Prokurorimi i koshave të rrinjë për zgjerimin e shërbimit	-Prokurorimi i 19 kontejnerve të rri prej 1,5 m3. -Caktimi i 19 lokacioneve për vendosjen e kontejnerave	Komuna e Bërvenicës NKP Vardar	2023 në vazhdimsi	246.000	Komuna e Bërvenicës Donacione
Vendosja e koshave për mbeturina nëpër shëtitore, rrugëve lokale, rrugve kryesore dhe nëpër sipërfaqe piblike	-Përzgjedhja e lokacioneve për vendosjen e koshave -Furnizimi i 30 koshave dhe vendosja e të njëjtave	Komuna e Bërvenicës NKP Vardar	2023 në vazhdimsi	30.000	Komuna e Bërvenicës Donacione

Sfera 3: Intervenimi për mbledhjen e mbeturinave inerte

Detyrat	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Buxheti (denarë)	Burimet financimit
Caktimi i lokacionit për mbeturina Inerte (mat. Ndërtimor, dhe etj)	-Formimi i ekipës për gjetjen e lokacionit adekuat për deponimin e riciklimin e materialit inert -Përpilimi i vendimit, -Miratimi i vendimit nga ana e Këshillit të komunës, -Sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm	Komuna e Bërvenicës JKP Vardar	2023-2025	30.000	Komuna e Bërvenicës NKP Vardar MAJPH

Sfera 4: Parandalimi i mberurinave

Detyrat	Aktivitetet	Institucioni Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti (denarë)	Burimet financiare
Fushata publike dhe edukimi	-Përpilimi i fletushkave informative -organizimin e 1 fushate edukative dhe 1 trajnim në shkolla	Komuna e Bërvenicës Nulla Otpad Shkollat Shoqatat dhe Konsulent	2023 në vazhdimsi	10.000	Komuna e Bërvenicës Nulla Otpad
Organizimi i akcioneve për mbledhjen e merurinave të ndryshme	-Realizimi i aksionit	Komuna e Bërvenicës JKP Vardar Shkollat fillore Shoqatat qytetare	2023 në vazhdimsi	30.000	Komuna e Bërvenicës NKP Vardar

Sfera 5: Organizimi I sistemit për mbledhjen e mbeturinave



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërënicës për vitin 2023

Detyrat	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Buxheti (denarë)	Burime financiare
Realizimi I fushatës publike për nevojën e reciklimit	-Përpilimi I planit të punës për ngritjen e vetëdijës, -Definimi I grupit të qëllimit, -Takime pune dhe ligjerata në nivele të ndryshme	Komuna e Bërënicës Konsulentë	2023 në vazhdimsi	20.000	Komuna e Bërënicës NKP Vardar
Vendosja e mbledhjes selective të letrës, ambalazhës plastike, qelqit, baterive dhe mbetjeve elektrike dhe elektronike	-Sigurimi I konstrukcionit finciar, -Caktimi I lokacioneve për qendrat e mbledhjes dhe deponimit, Furnizimi me kosha për selektimin e meturinave	Komuna e Bërënicës Kompanitë e Licencuara Konsulentë	2023 në vazhdimsi		Komuna e Bërënicës MAJPH Pako Mak Nulla Otpad

Sfera 6: Kompostimi I mbeturinave Biodegraduese

Detyrat	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Buxhet (denarë)	Burime financiare
Fillimi e procesit të biokompostimit qendrorë dhe vayhdimin e biokompostimit nëpër shtëpia	-Praktikimi I teknikave të reja për Biokompostim qendrorë, -Fushatë publike për edukimin e populates për selektimin e mbetjeve biodegraduese komostimin e të njejtit dhe shfrytëyimin	Komuna e Bërënicës NKP Vardar	2023 në vazhdimsi	70.000	Komuna e Bërënicës NKP Vardar MAJPH

Sfera 7: Deponitë e egra

Detyrat	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati kohorë	Buxheti (denarë)	Burimi I financimit
Përpilimi I planit për pastrimin e deponive	-Analizimi I terenit -Vlersimi I rrezikut -Vlersimi I mjeteve financiare të nevojshme për mbylljebn e deponive -Rangimi I deponive	Komuna e Bërënicës NKP Vardar 9është e nevojshme ndihma e konsuletëve)	2023 në vazhdimsi	30.000	Komuna e Bërënicës NKP Vardar MMJPH
Mbyllja dhe rehabilitimi I deponive të egra	-Ndarhja e mjeteve nga Buxheti -Kërkesë të mjeteve shtesë nga qeveria e RMV dhe MMJPH	Komuna e Bërënicës NKP Vardar	2023 në vazhdimsi	100.000	Komuna e Bërënicës NKP Vardar
Ndërtimi dhe montimi I	-Ndërtimi I tabelave (20)	NKP Vardar	2023 në vazhdimsi	20.000	Komuna e Bërënicës



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërvenicës për vitin 2023

tabelave ndalohet hudhja e mbeturinave	-Montimi I tabelave nëpër lokacione të parashikuara				NKP Vardar
Vendosja e rregullës të përshtatshme për monitorim dhe gjobitje	-Përpilimi I planit për monitorim të rregullt dhe përkohshëm -Gjobitja e shkelësve	Komuna e Bërvenicës	2023 në vazhdimsi	/	/

Sfera 8. Monitorimi i zbatimit të Planit dhe përditsimi i të njëjtit

Detyrat	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati kohore	Buxheti (denarë)	Burimi i finacimit
Zbatimi i detyrave të komisionit	Mbajtja e takimeve të rregullta të komisionit	Komuna e Bërvenicës NKP Vardar	2023 Në vazhdimsi	/	/
Evidentimi	Formimi i bazës me të dhëna	Komuna e Bërvenicës NKP Vardar	2023 Në vazhdimsi	/	/
Notimi i implementimit duke shfrytëzuar indikatorët e propozuar	Matja e rezultateve të arituara	Komuna e Bërvenicës NKP Vardar	2023 Në vazhdimsi	/	/

Realizimi i këtij programi për menaxhimin me mbeturina në Komunës së Bërvenicës për vitin 2023 do të varet në masë të madhe nga mjetet e ndara nga buxheti i Komunës së Bërvenicës.

Ky program hyn në fuqi në ditën e miratimit, i njëjti do të publikohet në “Fletoren Zyrtare të Komunës së Bërvenicës”, dhe do të aplikohet në vitin 2023.

Ky program hyn në fuqi nga dita e publikimit në Fletoren zyrtare të komunës së Bërvenicës



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërvenicës për vitin 2023

**Nr.01-
28.04.2022
Bërvenicë**

**Këshilli i komunës së Bërvenicës
Kryerar,
Bujamin Rushiti d.v.**



Programa për menaxhimin me mbeturina në Komuna e Bërvenicës për vitin 2022